



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 789/5 Prot

Tiranë, më 03.12.2020

V E N D I M

Nr.168, datë 03.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 789 prot., datë 21.10.2020, paraqitur prej nëpunësit *** , në lidhje me disa pretendime të tij për parregullsi gjatë procesit të ristrukturimit.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit ***** ,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 789 prot., datë 21.10.2020, nëpunësi ***** , ka parashtruar pretendimin se, transferimi i tij për shkak të ristrukturimit të institucionit, në pozicionin “Inspektor Peshkimi për Durrësin”, në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit, është i padrejtë, pasi, *së pari*, pozicioni i tij i mëparshëm i punës nuk është suprimuar dhe nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim kërkesat e vendit të punës dhe *së dyti*, punonjësi parashtron faktin se, gjendja e tij shëndetësore, e bën të pamundur udhëtimin e përditshëm në distanca të tilla siç është Durrësi, pavarësisht se është nën 45 km .

Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve, u kërkua dokumentacioni përkatës në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi e vërtetuar sa më poshtë:

Nëpunësi ***** është nëpunës civil, i pozicionuar në detyrën, “Inspektor (Peshkimi në Qendër), në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit”, në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës. Këtë cilësi ai e ka fituar pas fillimit të efekteve

të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pasi është emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 31, datë 24.2.2014, të titullarit të institucionit, dhe mbi këtë bazë është deklaruar “nëpunës civil në periudhë prove”, me aktin e DAP nr. 3279/8, datë 30.10.2014. Në përfundim të periudhës së provës, ai është konfirmuar “nëpunës civil”, me aktin nr. 72/1, datë 10.3.2015 (të dhëna këto, nxjerrë nga Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrjes të kryer pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, i cili ka përfunduar me vendimin nr. 148, datë 25.11.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil).

Në këtë pozicion, ka vazhduar pa ndërprerje deri në momentin që, pas miratimit të strukturës së re, me Urdhrin nr. 95, datë 17.7.2020, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të Organikës së Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”, e cila ka parashikuar shtim të numrit të punonjësve, institucioni është futur në proces ristrukturimi, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse.

Komisioni i ristrukturimit i ngritur në këtë rast, në përfundim të punës së tij, pasi ka shqyrtuar rastet për mundësinë e sistemimit të nëpunësve në vendet e lira ekzistuese, të krijuara rishtas apo të ristrukturuara, për nëpunësin *****, ka propozuar transferimin e tij nga pozicioni “Inspektor (Peshkimi në Qendër), në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit”, në pozicionin “Inspektor (Peshkimi për Durrësin), në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit”. Këtë propozim, e ka miratuar pa vërejtje edhe njësia përgjegjëse, (DAP), e cila nëpërmjet aktit nr. 4569/1, datë 7.10.2020 (pika 6 e tij), ka urdhëruar transferimin e përhershëm të nëpunësit *****, në pozicionin “Inspektor (Peshkimi për Durrësin), në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit”.

Kërkuesi e konsideron të padrejtë këtë transferim, me pretendimin se, pozicioni i tij i punës nuk është suprimuar e në të njejtën kohë nuk ka ndonjë ndryshim të kërkesave të posaçme të vendit të punës, përkundrazi, nga përmbajtja e akteve që materializojnë procedurën e ristrukturimit, rezulton se, struktura e re (miratuar me Urdhrin nr. 95, datë 17.7.2020, të Kryeministrit), parashikon shtim të numrit të punonjësve me 6 persona të tjerë, (konkretisht, nga 59 punonjës, që përmbante struktura e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 42, datë 7.3.2018, struktura e re përmban 65 punonjës), 5 nga të cilët, janë shtuar pikërisht në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit (ku punon kërkuesi).

Në të njejtën kohë, konstatohet se, pozicioni Inspektor Peshkimi në Qendër (pozicioni i mëparshëm i kërkuesit), jo vetëm nuk është suprimuar, por është plotësuar me transferimin paralel të një punonjësi që më parë kryente detyrën “Inspektor (Peshkimi për Lezhën)”, në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit.

Nga ana e institucionit, nëpërmjet shkresës nr. 306/1 prot., datë 26.10.2020, në përgjigje të shkresës nr. 789/1, datë 21.10.2020, të Komisionerit, “Kërkim dokumentacioni për verifikimin e kërkesës së paraqitur nga punonjësi *****”, arsyetohet se,

transferimi i dy inspektorëve të qendrës në sektorin e Durrësit, është bërë për shkak se, Porti i Durrësit, ka aktivitetin më të madh e për këtë shkak Inspektorët e Qendrës (***** dhe *****), në kuadër të këtij ristrukturimi, të transferohen atje, meqënëse edhe distanca nga qendra e banimit të tyre nuk është më shumë se 45 km, në përputhje me ndalimin e parashikuar në pikën 21, Kreu II, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.

Në vijim të arsytimit, nga ana e institucionit pretendohet se, plotësimi i pozicionit Inspektor Peshkimi në Qendër, me një punonjës që kryente më parë detyrën Inspektor Peshkimi për Lezhën, është kryer pasi ky i fundit, mban edhe pozicionin e Kryetarit të Njësisë Task-Forcë të institucionit, e cila është ngritur në mbështetje të Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit (*Urdhër nr. 5, datë 28.1.2019, i titullarit të institucionit*), duke gjykuar se, kjo detyrë, kryhet në mënyrë më efektive duke qenë në qendër, se nga Shëngjini.

Duke analizuar dhe vlerësuar gjithë dokumentacionin e mbledhur dhe rrethanat si më sipër, konstatohet se, nga pikëpamja formale-procedurale, procesi i ristrukturimit është kryer duke respektuar kërkesat e nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe të Udhëzimit nr.1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit*”.

Por, në përmbajtje, në rastin e transferimit të nëpunësit ***** , vlerësohet që është vepruar në kundërshtim me frymën e legjislacionit të shërbimit civil. Vërtetohet që pozicioni Inspektor Peshkimi në Qendër (*pozicioni i mëparshëm i kërkuesit*) nuk është suprimuar dhe as nuk kanë ndryshuar kërkesat e këtij pozicioni pune, që janë dy kushtet që mundësojnë prekjen e marrëdhënies ekzistuese të punësimit dhe transferimin e nëpunësit në një pozicion tjetër edhe pa pëlqimin e tij, siç parashikon pika 13, e Kreut II, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, e Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, prandaj nuk kishte arsye të prekej marrëdhënia ekzistuese.

Në rrethanat si më sipër, propozimi i Komisionit të Ristrukturimit dhe vendimi i Departamentit të Administratës Publike, për transferimin e punonjësit ***** nga pozicioni “*Inspektor (Peshkimi në Qendër)*” në pozicionin “*Inspektor (Peshkimi në Durrës)*” dhe plotësimi i këtij pozicioni me një punonjës tjetër, që kryente detyrën “*Inspektor (Peshkimi për Lezhën)*”, me pretendimin e institucionit se, transferimi është kryer duke respektuar kërkesat e procesit të ristrukturimit (*distanca jo më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit të transferuar*), vlerësohet i paligjshëm.

Në këtë rast, duhet thënë se, sipas pikës 21/b, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, distanca mbi 45 km, e vendit të ri të punës pas transferimit, është shkak refuzimi nga ana e nëpunësit të transferuar, vetëm në rast se transferimi i përhershëm, ka bazë shkurtimin apo ristrukturimin e vendit të mëparshëm të punës, gjë që në rastin tonë nuk ekziston si i tillë.

Gjithashtu konsiderohet i pambështetur në ligj edhe pretendimi tjetër i institucionit se, ky transferim është kryer për ti shërbyer më mirë punës, duke sjellë në këtë pozicion inspektorin e Peshkimit Shëngjin, i cili drejton edhe Task-Forcën e institucionit.

Procesi i ristrukturimit, është një proces që kryhet në bazë të rregullave të mirpërcaktuara nga legjislacioni i shërbimit civil dhe shërben për riorganizimin e institucionit pas shkurtimit apo shtimit të vendeve të punës, sikurse ka ndodhur në rastin konkret, por në asnjë rast, pavarësisht qëllimit që ka organi drejtues, ai nuk mund të shërbejë si shkak për lëvizjen e pambështetur në ligj, të punonjësve.

Në kushtet si më sipër, kur dy kërkesat kryesore të procesit të ristrukturimit, nuk konstatohen, arrihet në përfundimin se, përmbajtja e pikës 6, të aktit nr. 4569/1, datë 7.10.2020, të Departamentit të Administratës Publike, për transferimin e përhershëm për shkak të ristrukturimit, të nëpunësit ***** vjen në kundërshtim me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” (shkronja “d”, e nenit 109) dhe për këtë arsye, bazuar në nenin 113, të ligjit në fjalë, kjo pjesë e aktit administrativ, duhet të anulohet nga vetë organi publik, duke urdhëruar kthimin e nëpunësit në pozicionin e mëparshëm të punës, “Inspektor (Peshkimi në Qendër)”, në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit. Në të njëjtën kohë, organi publik duhet të anulojë edhe pikën 7, të aktit në fjalë, duke urdhëruar kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e tij të mëparshëm të punës “Inspektor (Peshkimi për Lezhën)”, në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të neneve 109/d, 113, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga ana e organit publik, Departamenti i Administratës Publike, që në lidhje me transferimin e nëpunësve ***** dhe *****, në kuadër të ristrukturimit të institucionit, të veprojë si më poshtë:

- Të anulohet pikën 6, të aktit nr. 4569/1, datë 7.10.2020, ku urdhërohet transferimi i përhershëm i punonjësit *****, nga pozicioni “*Inspektor (Peshkimi në Qendër)*”, në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit, në pozicionin “*Inspektor (Peshkimi për Durrësin)*”, në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit, duke e rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës si “*Inspektor (Peshkimi në Qendër)*”.
 - Të anulohet pikën 7, të aktit nr. 4569/1, datë 7.10.2020, ku urdhërohet transferimi i përhershëm i punonjësit *****, në pozicionin “*Inspektor (Peshkimi në Qendër)*”, në Sektorin e Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit, duke e rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës “*Inspektor (Peshkimi për Lezhën)*”.
2. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
 3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
 4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
 5. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, nëpunësi *****, si dhe çdo punonjës për të cilin preket marrëdhënia e punësimit sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha